

**KONTRATË DHURIMI KUOTASH  
TË SHOQËRISË “ARLA CLEANING SERVICES” Sh.P.K.**

---

Sot, në Tiranë, më date 30/09/2019 (dymijë e nentembedhjete), ne seline e shoqerise “ARLA CLEANING SERVICES” Shpk, me NIPT L81528006R ,prane Njesia Bashkiake Nr.11, Rruga “Don Bosko”, Nr.112, Tirane, ne prezencen e aksionerit te vetem te saj u redaktua kjo Kontrate Dhurimi Kuotash.

**Z.Vellis KONSTANTINOS**, shtetas grek, i biri i Nikolaos dhe Fanis lindur ne OULM (Gjermani) me 06/09/1966 dhe banues ne Tenarou,No.4,Katerini, Greqi. Me pasaporte me Nr.AN 3584492, madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar në cilësinë e Dhuruesit te 1 kuote qe perfaqson 100% te kapitalit themeltar te Shoqerise “ARLA CLEANING SERVICES” Sh.P.K.;

(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si “*Dhuruesi*”);

dhe

**Znj.Eleana BASHO**, me kombesi shqiptare, lindur ne Gjirokaster (Shqiperi) me 10/09/1987 dhe banues ne Kompleksi Ciklades,Sauk,Tirane me karte identiteti I75910084G madhor e me zotesi te plote juridike;

(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si “*Pranuesi i Dhurimit*”);

Në vijim e për efekt të kësaj Kontrate, Dhuruesit dhe Pranuesi i Dhurimit do të referohen veçmas si Palë/a dhe së bashku si Palë/t.

**MEQENËSE:**

a. Shoqëria “ARLA CLEANING SERVICES” Sh.P.K., është një shoqëri tregtare me pergjegjesi te kufizuar,e krijuar dhe organizuar në bazë të ligjeve shqiptare, e themeluar 21/03/2018 dhe e regjistruar ne daten 28/03/2018 prane QKB Tirane, me adrese: Njesia Bashkiake Nr.11, Rruga “Don Bosko”, Nr.112, Tirane, me NIPT L81528006R, (“**Shoqëria**”),

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000 (njqindmije) Lek (ALL) perbehet nga 1 (nje) kuote.Pjesemarrja ne kapitalin themeltar te shoqerise eshte, ne baze te kontributeve te bera, e ndare si me poshte:

- **Z.Vellis KONSTANTINOS**, zoteron 1 (nje)kuote, me vlere ALL 100,000 qe perben 100% te kapitalit baze te shoqerise;

 1

Sikurse rezulton nga ekstrakti i regjistrit tregtar lëshuar nga QKR për të dhënat e Shoqërisë, Dhuruesi zotëron 1 (nje) kuote të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë **(në vijim “Kuota”) si me siper.**

- b. Dhuruesi deshiron t'i dhurojne Pranuesit te Dhurimit Kuoten, ndersa Pranuesi i Dhurimit deshiron te fitoje Kuoten e dhuruara sipas kushteve dhe afateve te kesaj Kontrate;
- c. Në zbatim të kërkesave të Statutit të Shoqërisë, dhe pas miratimit të këtij transferimi sipas Vendimit të Asamblese të Ortakut të Vetem të Shoqërisë datë 20.03.2018, vendim i njohur dhe pranuar plotesisht nga Palet e qe i bashkelidhet kesaj Kontrate, Palët kanë vendosur të lidhin këtë Kontratë;

**ATËHERË,** duke qenë se ekzistojnë këto kushte paraprake, për të cilat Palët nuk kanë pretendime apo kundërshtime, Palët bien dakord për sa më poshtë vijon:

## **Neni 1      OBJEKTI**

- 1.1. Nëpërmjet kësaj Kontrate Dhuruesi i dhuron Pranuesit të Dhurimit dhe Pranuesi i Dhurimit fiton pronësinë nga Dhuruesi mbi gjithsej 1 (nje) kuote, e cila perfaqson 100% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.

## **Neni 2      DEKLARIMET DHE GARANCITE**

- 2.1 Dhuruesi deklaron dhe verteton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ai zotëron kuoten që do të transferohet sipas kësaj Kontrate, dhe ka të drejtën për t'a transferuar këte kuote dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Dhuruesit nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Dhuruesi.
- 2.2 Pranuesi i Dhurimit deklaron dhe verteton se në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ka tagra të plota për të pranuar kuotat nga Dhuruesi sipas përcaktimeve të kësaj Kontrate dhe se nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Pranuesi i Dhurimit nuk vjen në kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marreveshjet apo dokumente të tjera ligjore, subjekt i të cilave është Pranuesi i Dhurimit.





### Neni 3

### **TRANSFERIMI I TE DREJTAVE MBI KUOTAT.**

- 3.1** Pronësia mbi kuoten e Shoqërisë, objekt i kësaj Kontrate, kalon nga Dhuruesi tek Pranuesi i Dhurimit menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate. Kalimi i pronësisë së kuotes të Shoqërisë në favor të Dhuruesit do të regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me Ligjin 9901/2008, te ndryshuar dhe Ligjin 9723/2007, te ndryshuar.
- 3.2** Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Pranuesi i Dhurimit fiton pronësinë mbi Kuoten e dhuruar dhe bëhet ortak i vetem i Shoqërisë duke zotëruar gjithsej 1 kuote, që përfaqëson 100% kapitalin themeltar të Shoqërisë, ndërsa Dhuruesi humbet cilësinë e ortakut dhe largohet nga Shoqëria.
- 3.3** Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Pranuesi i Dhurimit gëzon të gjitha të drejtat për të regjistruar pronësinë mbi kuoten e zotëruar në emër të tij në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe pranë çdo institucioni tjetër shtetëror sipas legjislacionit në fuqi.

### Neni 4

### **TE NDRYSHME**

- 4.1.** Çdo kusht, klauzolë apo parashikim i kësaj Kontrate do të jetë i vlefshëm pavarësisht kushteve, klauzoleve apo parashikimeve të tjera dhe vlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi nuk do të çenohet nga pavlefshmëria e një kushti, klauzole apo parashikimi tjetër.
- 4.2.** Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit 9901/2008, te ndryshuar dhe Kodit Civil. Çdo konflikt që ka lindur si pasojë apo lidhet me këtë Kontratë do të zgjidhet në marrëveshje ndërmjet Palëve, në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e konflikteve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 4.3.** Kjo Kontratë hartohet në gjuhën shqipe në 4 (kater) kopje origjinale.

Kjo Kontratë pasi u lexua me zë të lartë e të qartë, dhe pasi u gjet në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u nënshkrua rregullisht prej Palëve si me poshte:


#### **DHURUESI**

Ortakët i vetem, **Vellis KONSTANTINOS**



(Nënshkrimi/firma)

Deklaroj se jam njohës i mirë i gjuhës shqipe.



#### **PRANUESI I DHURIMIT**

**ELEANA BASHO**

